



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:019260
Datë: 26.04.2024
Numri i dokumentit: 05623953

Ac.nr.3532/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Bislímaj, kryetar i kolegjit Halide Reka dhe Malsor Kryeziu, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit B. S. nga fshati Zh., Komuna e Gjakovës, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Y. B., avokat në Gjakovë, rruga “N. T.”, nr...., kundër të paditurës Komuna e Gjakovës, Drejtoria Komunale e Arsimit, me seli në Gjakovë, për kompensimin e shujtës ditore, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.85/2022, të datës 03.04.2023, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 25.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e të paditurës Komuna e Gjakovës, Drejtoria e Arsimit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.85/2022, të datës 03.04.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.85/2022, të datës 03.04.2023, ka vendosur si në vijim: I. APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditësit B. S. nga fshati Zh., Komuna e Gjakovës. II. DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit me seli në Gjakovë, që në emër të kompensimit të shpenzimeve për ushqim (shujta ditore) për periudhën nga data 13 janar 2019 e deri me 31 dhjetor 2020, për 448 ditë të prezencës në punë t’ua paguajë shumën prej 896.00 euro, me kamatë ligjore 8 %, e cila do të llogaritet nga data 28.01.2022 (data e paraqitjes së kësaj padie), e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet procedurale në shumë prej 238.00 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me detyrim.”

Kundër këtij aktgjykimi e paditura brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkëljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën e të paditurës si të bazuar, ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ta prish dhe çështjen t'ia kthej të njëjtës gjykatë në rigjykim apo ra refuzojë në tërësi kërkesëpadinë.

Paditësi përmes të autorizuarit të tij ka paraqitur përgjigje në ankesë përmes së cilës i ka kundërshtuar pretendimet ankimore të të paditurës me propozim që ankesa e të paditurës të refuzohet si e pabazuar ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet si dhe të obligohet e paditura që paditëseve t'ua kompensojë shumën prej 104,00 € në emër të përpilimit të ankesës.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi B. S., përmes të autorizuarit të tij, me datë 28.01.2022, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi për kompensimin e shujtës ditore, kundër të paditurës, me pretendimet se i njëjti është i punësuar tek e paditura dhe se në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit i takon kompensimi për ushqim për ditët e pranisë në punë (më detajisht si në petitumin e padisë si në shkresa të lëndës). Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëseve, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.85/22, të datës 03.04.2023, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të tij.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se “ nga parashtrimet e palëve ndërgjyqësore të paraqitura me padi dhe përgjigje në padi, gjykata ka gjetur se nuk është kontestuese se paditësi është i punësuar tek e paditura, e po ashtu nuk ishte kontestuese se pagimi i shpenzimeve të ushqimit për periudhën e kërkuar nuk iu është ekzekutuar. Kontestuese mbetet pamundësia financiare për pagimin e këtyre kompensimeve nga ana e të paditurës në drejtim të tani paditësit, e që në këtë rast gjykata u lëshua vetëm në vërtetimin e faktit kontestues në këtë procedurë. Duke iu referuar dispozitave të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), përkatësisht nenit 245, paragrafit 1 e lidhur me 35 paragrafi 7, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovës të datës 18.04.2017, si dhe të datës 22.01.2021, gjykata provave që kishin të bënin me vërtetimin e këtyre fakteve, iu fali besimin e plotë, ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre. Gjykata erdhi në përfundim se paditësit i takon shuma si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe atë duke bërë përllogaritjen e secilës ditë të prezencës në punë, me shumën që i takon sipas dispozitës së lartcekur, në shumë prej 2,00 për

një ditë pune, pasi që nga vërtetimi për ditët e prezencës në punë, i lëshuar nga SHFMU “A. Rr.” në B., me numër prot.271 i datës 07.02.2023, vërtetohet se paditësi për periudhën 2019/2020 deri me datë 31.12.2020 ka vijuar 448 dit punë.”

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë i është referuar nenit 5 paragraf i 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e lidhur me nenin 345 të LMD-së. Lidhur me kamatën ka vendosur konform nenit 382 të LMD-së dhe për shpenzimet e procedurës i është referuar dispozitave ligjore nga neni 449 dhe 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadsisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt e ka vërtetuar gjendjen faktike, nuk janë kontestuese ditët e pranisë së paditësit në punë për të cilën periudhë kohore kërkon kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, shujtës ngase paditësi B. S. është në marrëdhënie pune me të paditurën, përkatësisht është i punësuar në shkollën e mesme teknike F.M.U “A. Rr.” në fshatin Zh., Komuna Gjakovë si punëtor teknik- shërbyes dhe kjo provohet përmes Kontratës së Punës 01/289, të datës 06.10.2015 dhe për periudhën kohore nga viti 2019 gjer në vitin 2020, i njëjti ka gjithsej 448 ditë pune dhe kjo provohet përmes Vërtetimit me nr. protokollit 271, të datës 07.02.2023 të lëshuar nga e paditura SH.F.M.U “A. Rr.”.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, për arsye se me nenin 90 paragraf 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: “Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve”. Me paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se: “*Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: a) nivel të vendit, b) nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes*“. Me paragrafin 3 të këtij neni, përcaktohet se: “Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në Gjuhën Zyrtare të Republikës së Kosovës”. Me paragrafin 5 përcaktohet se: “*Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe*

punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive...". Me nenin 35 paragrafi 7, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021 përcaktohet se: "Të punësuarve, (anëtarë të SBASHK-ut), u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditë e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy €) Euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restaurantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensim për ushqim". Me nenin 45 paragraf 1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, përcaktohet se: "MASh, SBASHK dhe Ministria e Financave, angazhohen bashkërisht për t'i informuar dhe ndihmuar komunat, këshillat drejtuese të universiteteve dhe drejtoritë e shtëpive të studentëve që të bëjnë planifikimin me kohë të buxhetit dhe koston financiare për zbatimin e dispozitave të nenit 35. paragrafët 5, 7 dhe 11 kur të krijohen mundësitë financiare në buxhetin e Republikës së Kosovës, por jo më vonë se viti 2023".

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar se në këtë rast ekziston detyrimi juridik - civil, ndaj paditësit në emër të pagesës për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit gjatë ditëve të pranisë në punë, për arsye se me nenin 245 paragraf 1 të LMD-së, përcaktohet se: "*Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij*".

Gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit, duke e detyruar të paditurën që paditëseve t'iu paguaj në emër të ushqimit për ditët e kaluara në punë, me të drejtë është bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 e të vazhduar me datë 22.01.2021, të lidhur dhe nënshkruar nga Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK-ut) dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës (MASHT), e cila kontratë ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021 dhe se e njëjta është në pajtueshmëri të plotë me nenin 90 Ligjit të Punës.

Meqenëse e paditura ka vepruar në kundërshtim me Kontratën Kolektive të Kosovës, e njëjta tani detyrohet që paditëseve t'ua paguajë shumën e aprovuar sikurse në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe pretendimi se nuk kanë mjete buxhetore për të paguar, sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk qëndron pasi që në këtë pikëpamje, çfarëdo vështirësie që i atribuohet implikimeve financiare lidhur me zbatimin e kësaj kontrate, nuk e liron të paditurën nga përgjegjësia për përmbushjen e obligimit në raport me kërkesën e paditësit, gjegjësisht nuk paraqet bazë që kërkesëpadia të trajtohet si e pa themeltë.

Vendimi mbi kamatën e përcaktuar është në përputhje me dispozitën e nenit 382 të LMD-së, ndërsa vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitën nga neni 452 të LPK-së, ndërsa veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese janë arsyetuar drejtë, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragraf 1, pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
Ac.nr.3532/2023, më datë 25.04.2024.

Kryetari i kolegjit - gjyqtari,
Besnik Bislimaj